



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KESHILLI I BASHKISE SE QYTETIT KORCE

VENDIM

Nr 59 date 14.07.2010

**Per miratimin ne parim te Kontrates se Shkembimit midis Bashkise Korçe dhe Prokurorisë se Rrethit Gjyqësor Korçe dhe autorizimin e Kryetarit te Bashkise per nenshkrimin e saj**

Bazuar ne nenin 8 pika II gerrat "a" dhe "c" si dhe neni 32 germa "e" te ligjit 8652, date 31.07.2000 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar dhe nenet 757-760 te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise Keshilli Bashkiak pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur Drejtoria Juridike

**VENDOSI**

1. Te miratoje ne parim nenshkrimin e Kontrates se Shkembimit me pale kontraktuese Bashkia Korçe dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçe.
2. Te autorizojë kalimin ne pronesi te Prokurorisë se Rrethit Gjyqësor Korçe, te truallit prej 1000 m<sup>2</sup> te ndodhur ne lagjen 3, mbrapa vendit te quajtur « Panda » ne shkembim te godines, truallit nen godine dhe oborrit ku aktualisht ushtron funksionet Prokuroria.
3. Kalimi i pronesise dhe i te gjithë te drejtave pronesore mbi objektet te realizohet ne momentin qe te dyja palet kontraktuese Bashkia Korçe dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçe te jene pajisur me dokumentat e pronesise nga Zyra Vendore e Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Korçe.
4. Te autorizojë Kryetarin e Bashkise Z. Niko Peleshi te nenshkruaje kontraten e Shkembimit.
5. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike
6. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**KRYETAR I KESHILLIT**

**Gjergji PENDAVINJI**